



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva- Ministry of Health

Inspektorati Farmaceutik/Farmaceutski Inspektorat/Pharmaceutical Inspectorate

Raport		
Data/Date/Datum:	25.11.2025	Ref. No. 10/HB-020-25
Për/To/ Za:	Z. Forim Temaj, themelues i Qarkulluesit Farmaceutik me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale (barnatoret) "T-Pharm Aspirin C 16 Nj.Nr.15" Rruga "Qazim Berisha p.n." Prizren	
Përmes/Through/Preko:	Mr. Sc Remzie Thaçi, Drejtor i Departamentit të IF-së	
Nga/From/Od:	Mr.Ph. Habib Berisha, Inspektor farmaceutik Mr.Ph. Jeton Gutaj, Inspektor farmaceutik	
Lënda/ Subject/Tema:	Raport i inspektimit për Qarkulluesin Farmaceutik me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale "T-Pharm Aspirin C 16 Nj.Nr.15", Prizren	
Cc:	Dr. Arsim Berisha, Zv. Ministër i Shëndetësisë Z. Jahë Gecaj, U.D Sekretar i Përgjithshëm i MSh-së Mr.Ph. Labinot Zeqiri, Kryeinspektor Qëndror Shëndetësor Mr.Ph. Arian Ahmeti, Zëvendësues i Detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv në AKPPM	

I. Përmbledhja

Inspektorati Farmaceutik me datë 10.11.2025 ka kryer inspektim për prezencën e Stafit Profesional në Qarkulluesin Farmaceutik me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale (barnatoret) "T-Pharm Aspirin C 16 Nj.Nr.15" në Prizren.

Inspektimi i bazuar në Ligjin për Shëndetësi 04/L-125, Ligjin për Produkte dhe Pajisje Medicinale 04/L-190, Udhëzimin Administrativ për Qarkulluesit me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale 11/2015 dhe Ligjin 05/L-087 për Kundërvajtje të Republikës së Kosovës.

Pala është njoftuar si verbalisht ashtu edhe përmes dokumentit zyrtar se inspektimi është bërë me miratim nga Udhëheqësi i IF-së.

Prezent gjatë inspektimit ishte Znj. Anila Imami Pomaku teknike e farmacisë me numër të licencës KO-51507/A-05-4.

Në fund të inspektimit u përpilua procesverbali me numër 0005098 i cili i është lexuar palës dhe është nënshkruar nga pala prezente dhe inspektorët e rastit.

II. Metodologjia

Metodat e shfrytëzuara gjatë inspektimit:

- **Intervistimi:** Bashkëbisedimi me Znj. Anila Imami Pomaku.
- **Mbledhja e fakteve:** Licenca e barnatores, Çertifikata e biznesit, Licenca e farmacistit përgjegjës
- **Observimi:** Gjatë inspektimit janë kontrolluar dokumentacioni dhe prezenca e stafit profesional.

III. Faktet

Inspektorati Farmaceutik me datë 10.11.2025 ka kryer inspektim për prezencën e Stafit Profesional me qëllim të mbrojtjes së interesit publik/shëndetit publik në Qarkulluesin Farmaceutik me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale (barnatoren) "T-Pharm Aspirin C 16 Nj.Nr.15" në Prizren.

Janë kontrolluar dokumentacioni dhe prezenca e stafit profesional.

Inspektorati Farmaceutik kreu inspektim në barnatoren e lartëcekur në lidhje me prezencën e stafit profesional. Prezent gjatë inspektimit u gjet Anila Imami Pomaku teknike e farmacisë me numër të licencës KO-51507/A-05-4. Prezent nuk ishte farmacistja përgjegjëse e barnatores Mr.Ph. Belkiz Horosani.

Përmes procesverbalit me numër 0005098 pala është urdhëruar të veprojë vetëm sipas legjislacionit në fuqi!

IV. Konstatimet

- Qarkulluesi Farmaceutik me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale (barnatorja) "T-Pharm Aspirin C 16 Nj.Nr.15" me seli në Prizren posedonte licencë pranë AKPPM-së me numër të Licencës L5-0179/19/03/2024 me person përgjegjës Mr.Ph. Belkiz Horosani me numër të licencës së punës RKS-0396-17 dhe me pronar të barnatores Z. Florim Temaj.
- Barnatorja u gjet e hapur dhe shërbimi farmaceutik ofrohej nga Znj. Anila Imami Pomaku teknike e farmacisë me numër të licencës KO-51507/A-05-4.
- Në kohën e inspektimit në barnatore nuk u gjet prezent farmacisti përgjegjës ose ai zëvendësues me ç'rast konstatohet se pala ka vepruar në kundërshtim me Paragrafin 2 të Nenit 26 të Ligjit 04/L-125 për Shëndetësi, Paragrafin 2 të Nenit 14 të Ligjit Nr.04/L-190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale, Paragrafin 3 dhe 4 të Nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (Shëndetësi) Nr. 11/2015 për Qarkulluesin Farmaceutik me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale.

V. Rekomandimet

- Përmes procesverbalit me numër 0005098 pala është urdhëruar që të mos punojë pa prezencën e farmacistit përgjegjës ose atij të autorizuar për zëvendësim.
- Raportin e shoqëron Vendimi me gjobë numër 10/HB-020-25.

- Për plotësimin e rekomandimeve pala të njoftojë me shkrim Inspektoratin Farmaceutik

Raportit i bashkangjitet :

Kopja e Procesverbalit me numër serik 0005098.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health

Inspektorati Farmaceutik

PROCESVERBAL I INSPEKTIMIT

0005098

(Nr. Serik)

10/11/2025
(Data e fillimit të inspektimit)

13:05
(Ora e fillimit të inspektimit)
Nr. ARBK: 810971251

Në subjektin: Barnatore "T-Pharm Aspirin G 16 Nj. Nr. 15" Nr. licencës: LS-0178/19/23/2024
(Emërtimi i subjektit të inspektimit)

I udhëhequr nga: Pënar, Florim Temmaj, Farmacist përgjegjës; Balkis Hoxhani; RKS-0396-17
(Emri dhe mbiemri i udhëheqësit të subjektit të inspektimit)

Në adresën: Rr. Qazim Beutla P.W - Prizren, Republika e Kosovës
(Adresa e subjektit të inspektimit)

Inspektimi është realizuar nga:
Mr. Ph. Habib Beutla
Mr. Ph. Jeton Gubaj
(Emrat dhe mbiemrat e inspektorëve dhe personave të autorizuar për inspektim)

Me numër të dokumentit të identifikimit:
MSH-1096
MSH-0940
(Numri përkatës i dokumentit të identifikimit të inspektorit dhe të personave të autorizuar)

Në informatat kontaktuese: habib.b.beutla@gov.net
(Adresa elektronike e njërit nga inspektorët dhe numri zyrtar kontaktues)

Baza ligjore e inspektimit: Ligji 08/L-067, Ligji 04/L-175, Ligji 04/L-180

Procesverballi përpilohet për: Staf Profesional
(Lloji i inspektimit)

Inspektimi është bërë: me miratim ☒ pa miratim ☐

Inspektimi është bërë pa miratim përshkak të:
(Arsyeja e inspektimit pa miratim)

0005098

(Nr. Serik)

Pranimi i miratimit të inspektimit është refuzuar nga subjekti i inspektimit: po ☐ jo ☒

Ka munguar personi përfaqësues i subjektit të inspektimit: po ☐ jo ☒

Miratimi i inspektimit është vendosur fizikisht aty ku është kryer inspektimi: po ☐ jo ☒

Arsyeja për devjimimin e inspektimit nga lista e kontrollit të inspektimit është:

Mbrojtja e interesit publik / shëndetit publik.

(mbrojtja e interesit publik, shëndetit publik, sigurisë publike dhe/apo e mjedisit, nëse ka ndodhur)

Është inspektuar: Stafit profesional, Dokumentacioni relevant

(objekti i inspektimit, si për shembull lloji i dokumentacionit, i produktit, i objektit etj.)

Me rastin e inspektimit janë marrë:

(mostrat e produkteve, materialeve, mallrave, substancave apo prodhimeve, nëse ka ndodhur)

Gjetjet e inspektimit janë: Inspektori farmaceutik ka kryer inspektimin në barnatore e barnatoret në lidhje me presencën e stafit profesional. Prezent gjatë inspektimit v. gjet Anila Imami Parnaku teknike e farmaceutike KO-51507/A-05-8. Prezent nuk ishte farmaceutika përgjegjëse e barnatoret Belkiz Hoxham.

Pretendimet e subjektit të inspektimit janë:

(përmbledhja nga inspektori e shpjegimit dhe pretendimit të subjektit të inspektimit, pas dëgjimit të palës)

Subjekti i inspektimit ka vërejtje si vijon: Gjatë inspektimit farmacistia morri pjesë në barnatoret u kërkua për Amihato.

(vërejtjet eventuale të subjektit të inspektimit sa i përket gjetjeve të inspektimit)

Vendimet e marra janë si vijon: Ndeshkim sipas legjislacionit në fuqi. Vërehet barnatoret të vërejtjeve sipas legjislacionit në fuqi.

Inspektimi ka përfunduar më datë: 10/11/2025, në orën: 13:29

Anila Imami Parnaku

(nënshkrimi i subjektit të inspektimit apo përfaqësuesit të tij)

(nënshkrimet e anëtarëve të trupës inspektuese)